


## SHPERNDARJA E PARASE PUBLIKE NE RRUGE DHE SHKOLLA (JANAR 2008 - DHJETOR 2010)



\* Disa kompani kanë marrë tenderë në konsorcium me kompani nga qytete tjera.

Investimet publike i përshtaten interesit të partisë në pushtet jo planeve dhe ligjeve

## Blerja e territorit politik me paranë publike

ARTAN M. HARAQIA  
LORIK BAJRAMI

**PRISHTINË, MAJ** – Partitë politike fitojnë zgjedhjet nëpërmjet përkrahjes së bizneseve të afërta me to dhe pastaj përdorin pushtetin për të shpërblyer financuesit e tyre. Me të marrë pushtetin në nivel nacional, partia fituese përveç që

shpërblyen bizneset dhe grupet e interesit që i kanë siguruar ardhjen në pushtet, ajo fillon planifikimin e shpenzimeve publike në varësi të tërësishme nga objektivat e saja për të fituar dhe mbajtur komunat e caktuara.

Kështu, komunat që ndajnë gati në dysh votën mes dy partive kryesore janë njëkohësisht edhe përfitueset më të mëdha,

meqë pushteti tashmë i fituar në qendër përdoret për të siguruar vota në një komunë të tillë. Rasti më i mirë është komuna e Prizrenit, ku PDK-ja, sipas disa hulumtimeve të "Preportr", ka investuar në mënyrë disproporcionale më shumë sesa në komunat tjera.

Pra, shpërndarja e të ardhurave nga investimet publike, gjatë viteve 2008-2010,

në një masë të madhe ka përcjellë interesat e partisë në pushtet e jo ndonjë kriter apo plan të zhvillimit rajonal. Shpenzimet janë orientuar nga interesi i partisë në pushtet, në shpërfillje të plotë të kërkesës elementare për menaxhimin e parasë publike në bazë të ndonjë plani paraprak që del nga një program zhvillimor.

FAQE 3


### Fizionomia e korrupsionit në Kosovë

**PRISHTINË, MAJ** – Marrëdhëniet mes politikës dhe biznesit, transparenca në këtë segment, është një faktor vendimtar në mbisundimin e ligjit, në ndërtimin e një demokracie dhe sistemi institucional me integritet të fortë. Mënyra më e zakonshme dhe më e sigurt për të arritur këtë është kur sfondi financiar i politikës është lehtësisht i monitorueshëm nga publiku, gjë që gjerësisht definohet me fjalën transparencë. Ky është parakushti themelor për një demokraci të fortë dhe shtet të ligjit.

FAQE 2

### Magjia e 500 eurove në politikë

Shumica e financuesve të PDK-së, që kanë marrë tenderë publik, kanë deklaruar se kanë dhënë 500 euro donacion për këtë parti. Megjithatë, në disa raste, raportet e auditorit tregojnë se ka një shpërputhje enorme mes donacioneve të deklaruara dhe atyre të dhëna në të vërtetë. Miliona euro para publike janë dhënë për kompanitë që deklarojnë se i kanë dhuruar 500 euro partisë në pushtet.



FAQE 7

### Tenderët kundërligjorë

**PRISHTINË, MAJ** – Shkelja e ligjit në tenderët publik është bërë haptazi nga disa ministri të qeverisë së Kosovës. Disa miliona euro janë dhënë në kundërshtim të hapur me ligjin. Thyerja e ligjit në një pjesë të tenderëve të hulumtuar nga "Preportr", është konfirmuar edhe nga vetë zyrtarë të institucioneve të Kosovës.

FAQE 6

# Fizionomia e korrupsionit në Kosovë



AVNI ZOGIANI

## VIJON NGA FAQJA E PARË

... Kur ky segment, pra marrëdhënia mes politikës e biznesit privat, ngelet i errët, i errët ngelet edhe vizioni i një vendi për të ardhmen e tij. Sipas shumë raporteve vendore dhe të huaja, por edhe sipas eksperiencës sonë shumëvjeçare në fushën e gazetarisë, dhe në fund pas kësaj eksperience me raportet hulumtuese që do të lexoni në shtojcën “Preportr”, Kosova është një vend me mungesë kritike të transparencës së pikëtakimit mes sektorit privat dhe atij publik.

Mirëpo, duke e thënë këtë, s’kemi nxjerrë në pah asnjë të re. Kështu ka ndodhur edhe në shtete tjera, jo vetëm në Kosovë. Mirëpo, dallimi qëndron në shkallën e mungesës së transparencës dhe llogaridhënies. Në Kosovë, në mungesë të transparencës së vendim-marrjes, krijohet ambient për ndikime të forta të të ashtuquajturve “këshilltarë” vendor e ndërkombëtarë, që me një term më adekuat mund të quhen, dilerë vendor dhe të huaj. Nëpërmjet këtij ndikimi, interesat nga sektori publik transferohen në interesa private të individëve apo kompanive, sidomos të huaja, por edhe të vendit. Ky transferim i vlerave e aseteve publike në pronësi private ndodhë nëpërmjet tenderëve publik, procesit të privatizimit si dhe vendimeve strategjike në fushën ekonomike. Shpesh debati sillet rreth asaj se kush në të vërtetë është përfituesi kryesor. Nëse për shembull marrim para sysh se mbi 90% e kapitalit në Kosovë kontrollohet nga institucione financiare të huaja, atëherë fillojmë ta kuptojmë se ku qëndron problemi.

Ndikimet në vendim-marrje nga prapaskena të errëta mund të kuptohen edhe nëse bëjmë një lloj ndarje të niveleve të eksploatimit të pasurisë publike nga interesa private në tri shkallë në varësi të vlerave që janë në pyetje. Mund të thuhet që ky proces i përvetësimit të aseteve e vlerave publike për llogari private bëhet përgjithësisht në tri shkallë, që mbase mund t’i ndajmë në:

- shkalla e ulët (tenderët publik të zakonshëm që bien kryesisht në fushën e mallra dhe shërbime);
- në shkallë të mesme (tenderët e lidhur me projekte nacionale, kryesisht infrastrukture dhe energjetike, por edhe kontrata të rëndësishme me kompanitë publike) dhe;
- në shkallë të lartë (që lidhet kryesisht me dokumente strategjike dhe vendime për kontrata të rëndësishme mes sektorit publik dhe atij privat – fjala vjen autostrada, koncesionimi i Aeroportit, Strategjia për energjinë, apo edhe Strategjia për PTK-në).

Në të tri këto shkallë ekziston një vendim-marrje e mbyllur që varësisht nga shkalla përfshinë aktorë të ndryshëm. Në shkallën e ulët kryesisht kemi të bëjmë me dilerë vendor të afërt me partitë politike, që menaxhojnë tenderët e vegjël publik në atë mënyrë që kompanitë që financojnë partitë shpërblehen me tenderë. Pra, është kryesisht segment i shpenzimit të parasë publike në projekte të vogla, që kontrollohet kryesisht nga individë dhe kompani nga vendi. Ndikimi në këto raste konsiston kryesisht në nivele të organizatave buxhetore dhe kanë për objektivi gati në të gjitha rastet, parandë e buxhetit. Pra, kemi të bëjmë kryesisht me tenderë të shkallës prej qindra mijëra deri në disa miliona euro.

Aktorët e përfshirë në shkallën e mesme të përvetësimit të aseteve e vlerave publike janë edhe vendorë, por sidomos të huaj. Ata ndikojnë direkt në vendimet e niveleve të larta qeverisëse, para së gjithash në kryeministri, por edhe në borde e agjencive publike. Objektivi kryesor i këtyre akterëve, sidomos atyre të huaj, janë kompanitë publike, të cilat për këto dhjetë vite krijuan vlera të mëdha pasurie. Këto janë kryesisht kontrata për furnizime apo shërbime “konsulencë” që kryesisht kapin nivelin prej pesë milionë euro e lart.

Shkalla më serioze e përvetësimit të aseteve publike, shkalla e lartë, lidhet me krijimin e dokumenteve strategjike sidomos në fushën e kompanive publike. Këtu pra kemi të bëjmë me biznese serioze që as që mund të krahasohen me vlerat në dy nivelet tjera të përvetësimit. Akterët që përfitojnë nga ky segment janë të huajt, kurse vendorët janë vetëm të ashtuquajturit vendim-marrës. Një term i krijuar enkas për Kosovën në këtë fushë janë të ashtuquajturit “këshilltarë të transaksionit”, të cilët në Kosovë sillen nëpërmjet ambasadave të huaja dhe zyra të Bankës Botërore. Ata formalisht nuk i marrin vendimet, por kryesisht i shkruajnë ato. Janë të pamëshirshëm ndaj ekonomisë vendore dhe proponentët të asaj që në gjuhën e lëvizjeve anti-globaliste quhen “asset rip-off”, që në përkthim të lirë mund të thuhet “zhvatje/gërryerje e aseteve”. Disa dokumente të tilla janë përgatitur deri më sot në Kosovë dhe më të njohurat janë, Strategjia për Energjinë, Strategjia për privatizimin e PTK-së, Strategjia për Trepçën, kontrata për ndërtimin e Aeroportit dhe Koncesionimi i Aeroportit të Prishtinës. Mirëpo, kontrata të këtij niveli janë edhe ato për furnizim me energji elektrike, apo blerje të pajisjeve dhe riparim të sistemeve të termocentraleve.

Këto dokumente kryesisht janë nënshkruar pa ndonjë rezistencë në ekzekutivin e Kosovës, por jo rrallë janë imponuar dhunshëm në Parlamentin e Kosovës. Madje në lidhje me Strategjinë për energjinë, sipas ish-ministres së energjisë, Luljeta Pula-Shiroka, këshilltarët e Bankës Botërore dhe USAID, kanë bërë presion të hapur ndaj institucioneve të Kosovës për ta kaluar këtë dokument. Dokumenti në masë të konsiderueshme merr nga duart e

publikut kosovar asetin më të rëndësishëm dhe potencialin e vetëm për zhvillim qenësor ekonomik, qymyrin dhe sektorin e energjisë, për ta rezervuar për investuesit e ardhshëm.

Varësisht nga shkalla e përvetësimit të aseteve publike, mungesa e transparencës përkeqëson në një linjë eksponenciale peshën që përbën një dokument a tender. Kështu, nëse dëshirojmë të vlerësojmë mungesën e transparencës në të tri këto nivele dhe shkallëzime mungesën e transparencës nga një në tre, atëherë mund të thuhet se nëse mungesa e transparencës në shkallën e ulët të përvetësimit të pasurisë publike është një në fuqinë një, në shkallën e mesme është dy në fuqinë dy, kurse në shkallën e lartë, është tre në fuqinë tre. Me fjalë tjera, nëse në shkallën e ulët kemi të bëjmë me një mjegull rreth informacioneve që tregojnë lidhjen e interesave të politikës me sektorin privat, në shkallën e lartë është mjegull dhe errësirë bashkë me një shikueshmëri afër zeros. Në anën tjetër, derisa të dy nivelet e para, pra ajo e ulët dhe e mesme, kryesisht kanë të bëjnë me një metodë teknike të përvetësimit të aseteve publike (që kryesisht shfaqet nëpërmjet kriterave teknike të tenderëve), në shkallën e lartë, kemi të bëjmë me një metodologji tjetër që është tërësisht politike. Në emër të institucioneve të rëndësishme ndërkombëtare (kryesisht Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtarë), apo edhe të qeverive “mike të Kosovës”, këshilltarë ndërkombëtarë që në praktikë sillen si matrapazë, takojnë vendorët që marrin vendime dhe i urdhërojnë si të sillen, çka të votojnë e çka të thonë. Është pra ndikim direkt politik që jo vetëm dëmton interesat publike, por edhe cenon funksionimin e demokracisë duke e bërë që ajo të funksionojë jo vetëm nga lart-poshtë, por nga jashtë-brenda. Është interesante që tërë debati në shoqëri karakterizohet me fokusim në shkeljet dhe manipulimet që i takojnë kryesisht shkallës së ulët të përvetësimit të aseteve publike. Kjo para së gjithash, se në shkallën e mesme dhe të lartë thjesht kemi të bëjmë me ndërkombëtarë. Nëse në ekranin e radarit të monitoruesve të korrupsionit qofshin ata të huaj apo vendor, shfaqet ndonjë ndërkombëtar, ata trajtohen si të padukshëm, të paprekshëm. Për shembull, as që imagjinohet që në ambientet e gazetarëve, shoqërisë civile, apo edhe politikës, të debatohet rreth një konflikti interesi të ndërkombëtarëve në Kosovë. Institucionet ndërkombëtare mund të ushtrojnë funksione e role me konflikte interesi dhe nga ato mund të përfitojnë asete publike dhe kjo nuk shikohet nga askush si diçka e dënueshme.

Është e çuditshme me tërë këtë përfshirje të institucioneve ndërkombëtare në qeverisjen e vendit, nuk është raportuar as edhe një rast i ndikimit të zyrave publike me qëllime të përvetësimit të aseteve publike. Një rast i tillë për shembull është ndikimi dhe presioni i “këshilltarëve” të Bankës Botërore, për të cilin po flet sot ish-ministria e energjisë. Mirëpo, nevoja për të pasur një ambient tërësisht të lirë për të

vepruar, i ka shtyrë ndërkombëtarët që të krijojnë një fushë interesi për politikën vendore. Kështu, në shkallën e ulët të përfitimeve nga sektori publik politikanë e biznesmenë vendorë frymojnë pa pasur ndonjë frikë nga drejtësia “kosovare” që për dhjetë vite ka qenë e dominuar nga ndërkombëtarët. Me fjalë tjera, duke iu lënë ndërkombëtarëve të lirë shkallën e mesme dhe të lartë të korrupsionit, politikanët vendorë thjesht kanë në zotërim shkallën e ulët duke mundësuar kështu financimin e vet-vetes pa ndonjë hajër për vendin e tyre. Në anën tjetër, të huajt kanë krijuar një lloj sistemi të eksploatimit efektiv të tregut kosovar, duke nxjerrë jashtë shumicën e vlerave dhe duke e varfëruar në vazhdimësi vendin për dhjetë vite me radhë.

“Preportr”, një projekt i Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese, do të provojë që në vazhdimësi me disa raportime si këto që i keni sot në dorë të hulumtojnë pikërisht këtë marrëdhënie mes sektorit privat dhe atij publik, gjegjësisht zbrëthimin e përdorimit të zyrave publike me qëllim të përfitimit direkt ose indirekt të akterëve politik e të biznesit nga sektori publik. Në këtë numër hulumtimet janë fokusuar në segmentin që lidh këta dy sektorë që kryesisht i takojnë dy kategorive të para të përvetësimit të aseteve publike, pra shkallës së mesme dhe të ulët. Në mënyrë konsekuente do provojmë që të zbrëthojmë të tri shkallët e korrupsionit në Kosovë.

Duhet ta theksojmë që gjatë këtij hulumtimi, reporterët e Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese, gjegjësisht, “Preportr”, kanë hasur në pengesa serioze dhe sistematike të mbledhjes së informacionit që normalisht do të duhej të ishte pronë e publikut. Në vazhdimësi reporterët e “Preportr” kanë hasur në një rezistencë të autoriteteve për të dhënë informacion dhe në një zellshmëri të jashtëzakonshme të tyre për reduktimin e informatave që janë të qasshme dhe kjo ka pasur për qëllim pikërisht fshehjen e marrëdhënies së politikës e zyrave publike me sektorin privat. Ta zëmë për shembull, derisa kjo qeveri ka ardhur në pushtet në formularët e Agjencionit Kosovar për Regjistrimin e Biznesit, ka pasur shumëfish më shumë informacion mbi bizneset. Më 2008 këto informacione janë reduktuar në minimum dhe nëse dikush dëshiron të bëjë një hulumtim ai duhet të paguaj shuma të mëdha parash për të paguar “përgatitjen” e informacionit nga zyrtarët e këtij agjencioni, informacion që normalisht do duhej të ishte pronë e publikut.

Kjo që keni sot në dorë është shtojca e tretë e botuar nga Organizata COHU! që për herë të parë del nën siglën e Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese, me projektin “Preportr”. “Preportr”, do të ndjek edhe mjete tjera për të ekspozuar përdorimin e zyrave publike për përfitime të partive dhe të politikanëve, por jo vetëm kaq. “Preportr” do të ketë edhe një botim të veçantë online, që do të marrë fizionominë e një magazine me një identitet specifik. ■





Foto: Lorik Bajrami

Investimet publike i përshtaten interesit të partisë në pushtet jo planeve dhe ligjeve

# Blerja e territorit politik me paranë publike

## VIJON NGA FAQJA E PARË

Kështu, shumat milionëshe nga investimet publike kanë shkuar në komuna si dhe u janë dhënë kompanive të caktuara, ku kriteret vendimtar kanë qenë ose rajonet prej nga vijnë ministrat ose aty ku interesi elektoral i partisë ka qenë më i madh.

Po ashtu, investimet publike të bëra gjatë këtyre dy viteve kanë qenë joproporcionale në raport me madhësinë e vendbanimeve dhe numrin e banorëve nëpër komunave të ndryshme, sepse para së gjithash janë të orientuara politikisht. Një hulumtim i “Preportr”, i cili është bazuar në mbi 98 % të kontratave që janë nënshkruara nga Ministria e Transportit dhe ajo e Arsimit përgjatë viteve 2008-2010, nxjerrë në pah që një shumë prej mbi 416 milion euro u është shpërndarë 199 kompanive të ndryshme përmes 385 tenderëve publik.

**Investimet totale nga  
MTPT + MASHT  
(Janar 2008 – Dhjetor 2010)**

Total

**416,173,511 €**

199 kompani  
përfutuese  
385 tenderë

## Kompanitë që vijnë nga rajonet e ministrave dhe nga bastionet e PDK-së

Hulumtimi i “Preportr” tregon që disa qytete kanë qenë më të rëndësishme për PDK-në. Ministria e Transportit si dhe ajo e Arsimit janë kujdesur që të dërgojnë miliona euro tek ato kompani ku ose kanë prejardhjen ministrat e sektorëve gjegjëse ose tek ato kompani ku interesi elektoral i PDK-së ka qenë dominant, duke i pasur gjasat më të mëdha që të fitojnë në zgjedhjet lokale dhe nacionale.

Nga ky hulumtim, del se kompanitë që vijnë nga Malisheva dhe Theranda, komunat prej nga vijnë ish Ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj, respektivisht ish Ministri i Transportit, Fatmir Limaj, kanë marrë miliona euro para të buxhetit të Kosovës duke kaluar komuna shumë më të mëdha siç janë Peja, Mitrovica apo edhe Gjakova. Në total, 23 kompanitë nga Theranda dhe Malisheva kanë marrë 59 tenderë duke përfutuar mbi 62 milion euro. Në të njëjtën periudhë, “Preportr” ka vërtetuar se nga këto dy ministri, vetëm 15 kompani nga Peja, Mitrovica dhe Gjakova, kanë përfutuar tenderë në vlerë prej mbi 12.5 milion eurosh. Nga këto të fundit, vetëm 3 kompani janë nga qyteti i Mitrovicës që kanë përfutuar tenderë nga MASHT-i dhe MTPT-ja.

## Rajonet prej nga vijnë kompanitë përfutuese

|                                   |                       |                          |
|-----------------------------------|-----------------------|--------------------------|
| <b>Therandë + Malishevë</b>       | <b>+62 milion €</b>   | 23 kompani<br>59 tenderë |
| <b>Pejë + Mitrovicë + Gjakova</b> | <b>+21.9 milion €</b> | 15 kompani<br>31 tenderë |

## Rajonet prej nga vijnë kompanitë përfutuese

|                  |                     |                           |
|------------------|---------------------|---------------------------|
| <b>Prishtina</b> | <b>121 milion €</b> | 71 kompani<br>123 tenderë |
| <b>Prizreni</b>  | <b>71 milion €</b>  | 16 kompani<br>42 tenderë  |


Pak a shumë, trend i njëjtë i dhënies së parave të buxhetit të Kosovës, kompanive prej nga interesi elektoral i PDK-së ka qenë dominues, vërehet edhe me komunat tjera të vendit. Beteja fillestare për tu bërë partia e parë që prej vitit 2007 ka qenë sidomos Prizreni. Në fakt kompanitë nga Prizreni, qyteti që gjatë fushatës për zgjedhjet lokale të vitit 2009 ishte cilësuar Jerusalemi i PDK-së, kanë përfutuar shumë më tepër në krahasim me kompanitë e qyteteve të tjera gjatë punës dy vjeçare. Totali që nxirret nga ky hulumtim tregon një disbalancë të madhe në mes të kompanive të Prizrenit, përfutuese të tenderëve nga MASHT-i dhe MTPT-ja dhe kompanive të kryeqytetit. Përdërisa 61 kompani të Prishtinës kanë përfutuar mbi 121 milion euro nga 123 tenderë, vetëm 16 kompani të Prizrenit kanë marrë mbi 71 milion euro përmes 42 tenderëve.

Po ashtu, kompanitë që vijnë nga komunat që konsiderohen bastione të forta të PDK-së, kanë përfutuar shuma milionëshe nga buxheti i Kosovës në krahasim me kompanitë, komunat e të cilave u përkasin kundërshtarëve politikë si ato të LDK-së apo të AAK-së.

Kompani nga Shtimja, Skënderaji, Drenasi si dhe Ferizaj kanë marrë një shumë prej mbi 30 milion euro më shumë se sa kompanitë nga komuna e Podujevës, Deçanit, Istogut dhe Junikut.

Në anën tjetër, edhe kur janë ndarë tenderë në komunat “fqinje”, zakonisht një shumë e konsiderueshme e parave kanë shkuar në llogari të kompanive të afërta me njerëzit e partisë në pushtet.





Nga ky grafik shihet se komuna e Deçanit si dhe ajo e Istogut u kanë ikur trendit të përfitimit të komunave në interes të PDK-së, për sa i përket kompanive që kanë përfituar tenderë. Arsyeja e vërtet pse disa kompani nga Deçani si dhe nga Istogu kanë përfituar është se këto kompani, siç do ta shihet më poshtë, janë në pronë të njerëzve të afërt me PDK-së.

### Kompanitë e afërta me PDK-në

Paraqitja e shpërndarjes së parave publike vetëm në aspektin se nga cilat komuna vijjnë kompanitë, të cilat kanë fituar tender, nuk jep një pasqyrë të plotë se kush realisht janë përfituesit e vërtetë të milionave eurove të taksapaguesve të vendit.

“Preportr” ka vërejtur se ekziston një lidhje në mes të relacionit se prej nga vijjnë pronarët e kompanive si dhe komunës se ku janë regjistruar këto kompani që kanë përfituar tender. Po ashtu, “Preportr” ka gjetur se kompani që vijjnë nga komuna të cilat tradicionalisht nuk kanë qenë nën qeverisjen e PDK-së, kanë fituar tenderë sepse kanë qenë në konsorcium me kompani që vijjnë nga rajone të cilat cilësohen si komuna të kësaj partie. Veç kësaj, “Preportr” ka vërejtur se ka edhe raste që kompani të caktuara, që vijjnë nga komuna që kanë qenë jashtë qeverisjes së PDK-së, kanë fituar tenderë milionësh, pasi që pronarët këtyre kompanive kanë lidhje familjare me zyrtarë të PDK-së.

Në rastin e komunës së Prishtinës, është vërejtur se ka kompani përfituese të tenderëve prej disa dhjetëra milionësh, që kanë qenë në konsorcium me kompani që vijjnë nga komuna e Malishevës si dhe komuna e Ferizajt. Kompania “Euro-kos” nga Prishtina, ka marrë tenderë publik prej dhjetëra miliona eurosh nga MTPT-ja, ku në shumicën e rasteve ka qenë në konsorcium me kompani nga rajoni i Drenicës apo edhe me kompani që vjen nga komu-

na të PDK-së, siç është Ferizaj. Po ashtu, kompania “Kastrioti”, nga Prishtina ka marrë tenderë në vlerë prej mbi 5 milionë euro, pronari i së cilës është nga rajoni i Drenicës. Veç këtyre, kompania “Damastion Projekt” ka marrë tenderë në vlerë afër 3 milionë eurosh, në konsorcium me kompanitë nga Drenasi dhe nga Ferizaj. Kompania “Ada Consulting Group” poashtu nga Prishtina, që për pronarë ka Avni Kastratin nga Buroja, ka fituar tenderë në vlerë afër 2 milion euro. Kompania “Ada Consulting Group”, ka për këshilltarë Fadil Demakun, deputet i PDK-së në Parlamentin e Kosovës, dhe i cili është vëllai i kryetarit aktual të Drenasit, Nexhat Demaku.

|                                                                                                                                                                                                                  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Kompania, “Euro-kos”, nga Prishtina në konsorcium me kompaninë “Burimi Malishevë” nga Malisheva, si dhe me kompaninë “Drenica” nga Ferizaj, ka fituar tender nga MTPT-ja në vlerë prej <b>17,294, 971 €</b> . |
| 2. Kompania, “Kastrioti”, nga Prishtina, pronari i së cilës është nga rajoni i Drenicës, ka fituar tender nga MTPT-ja në vlerë prej <b>5,399,707 €</b> .                                                         |
| 3. Kompania, “Damastion Projekt”, nga Prishtina, në koncorzium me kompaninë “NN Shkambi” nga Drenasi, ka fituar tender nga MTPT-ja në vlerë prej: <b>2,997,196 €</b> .                                           |
| 4. Kompania, “Ada Consulting Group”, nga Prishtina, që si këshilltarë ka Fadil Demakun, deputet i PDK-së në Parlamentin e Kosovës, ka fituar tender nga MTPT-ja në vlerë prej: <b>1,922,810 €</b> .              |

Komuna e Istogut edhe pse në vazhdimësi ka qenë nën udhëheqjen e LDK-së, kompani të caktuara kanë fituar miliona euro nga investimet publike pasi që janë të afërta me struktura të PDK-së. Kompania “Albes” nga Istogu, që ka pronar Hajredin Mavraj, shihet si e afërt me struktura të PDK-së, pasi që pronari në fjalë është familjar i botuesit të gazetës “Epoka e Re”, Muhamet Mavraj, gazetë e cila tradicionalisht ka qenë e afërt me PDK-në.

Në anën tjetër, Komuna e Deçanit po ashtu ka përfituar shuma milionëshe nga tenderët publik, edhe pse kjo komunë asnjëherë nuk ka qenë nën qeverisjen e PDK-së. Sidoqoftë, arsyeja pse kompani nga komuna e Deçanit kanë përfituar nga tenderët publik, ka të bëjë pjesërisht edhe me lidhjet familjare të pronarëve të kompanisë së caktuar me deputet të PDK-së. Kompania, “Arfa” nga Deçani, me pronar Fadil Hadërgjonaj, ka përfituar afër 2 milion euro nga MTPT-ja. Fadil Hadërgjonaj është familjarë i deputetes së PDK-së, në Parlamentin e Kosovës, Safete Hadërgjonaj.

|                                                                                                 |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Kompania “Albes” nga Istogu, ka fituar tender nga MTPT-ja në vlerë prej <b>5,702,519 €</b> . |
| 2. Kompania “Arfa” nga Deçani” ka fituar tender nga MTPT-ja në vlerë prej <b>1,896,563 €</b> .  |

### Raportimet e mediave për kompani të afërta me PDK-në

Në vazhdimësi, media në Kosovë ka raportuar se si kompani të afërta me njerëz të PDK-së kanë fituar tenderë nga institucione publike. Në këtë numër, “Preportr”, ka gjetur që një shumë afër 40 milionë euro u është dhënë kompanive të ndryshme nga Ministria e Transportit si dhe ajo e Arsimit, kompani që direkt kanë financuar fushatën elektorale të PDK-së së vitit 2009. Po ashtu, gazeta “KOHA Ditore”, muaj më parë kishte raportuar se si kompani të caktuara kanë përfituar miliona euro, kompani të cilat figurojnë në raportet zyrtare të KQZ-së si financuese të fushatës elektorale së PDK-së të vitit 2009. Kurse, gazeta “Prishtina Insight”, në njërin prej numrave të sajë, kishte raportuar se si kompani të afërta me ministrin e Transportit, Fatmir Limaj, kanë fituar dhjetëra miliona euro nga kontratat për shtrimin e rrugëve. Në vetëm këto tri medime të shkruara, mund të nxirret që një shumë afër 63 milion euro, nga MTPT-ja dhe MASHT-i, u është dhënë kompanive të cilat në një mënyrë janë të lidhura me PDK-në, si financuese të fushatës elektorale ose si të afërta me njerëz brenda strukturave të partisë.

| Miliona euro për kompanitë e afërta me PDK-në                                                                      |  |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
| Prishtina Insight                                                                                                  |  |
| 1. <b>Delia Group</b> , 1 tender MTPT, vlera totale <b>11,760,439 €</b> .                                          |  |
| 2. <b>AHN Group &amp; Timi Krsko</b> , 1 tender MTPT, vlera totale <b>5,792,435 €</b> .                            |  |
| Koha Ditore                                                                                                        |  |
| 3. <b>R. Rukolli</b> , 1 tender MTPT, vlera <b>288,799 mijë euro</b> . 2 tenderë MASHT, vlera <b>1,180,836 €</b> . |  |
| 4. <b>Ndërtimi</b> , 2 tenderë MTPT, vlera <b>484,581 mijë euro</b> . 2 tenderë MASHT, vlera <b>336,961 €</b> .    |  |
| 5. <b>Jehona</b> , 2 tenderë MTPT, vlera <b>688,285 €</b> .                                                        |  |
| 6. <b>Burimi</b> , 2 tenderë MTPT, vlera <b>12,953,264 €</b> .                                                     |  |
| Preporter                                                                                                          |  |
| 7. <b>Getoari</b> , 3 tenderë MTPT, vlera <b>3,469,557 €</b> . 1 tender MASHT, vlera <b>689,626 €</b> .            |  |
| 8. <b>Engineering</b> , 3 tenderë MASHT, vlera <b>1,735,631 €</b> .                                                |  |
| 9. <b>Bageri</b> , 1 tenderë MTPT, vlera <b>829,569 €</b> .                                                        |  |
| 10. <b>Bajraktari</b> , 1 tenderë MTPT, vlera <b>123,287 €</b> .                                                   |  |
| 11. <b>Beni Com</b> , 5 tenderë MTPT, vlera <b>9,157,830 €</b> .                                                   |  |
| 12. <b>Tali</b> , 6 tenderë MTPT, vlera <b>5,457,108 €</b> .                                                       |  |
| 13. <b>Bejta Commerce</b> , 3 tenderë MTPT, vlera <b>7,545,543 €</b> .                                             |  |
| 14. <b>Magjistrerja</b> , 1 tender MTPT, vlera <b>291,251 €</b> .                                                  |  |
| <b>Këto kompani gjithsej kanë fituar 37 tenderë që arrijnë shifrën e</b>                                           |  |
| <b>62,785,002 €</b>                                                                                                |  |

### Investimet në rajonet e minis-trave dhe në bastionet e PDK-së

Sa i përket përfitimit të rajoneve të veçanta, Drenica del të jetë rajoni me më së shumti investime nga MTPT-ja. Madje qyteza e Skenderajt ka pasur më shumë investime se sa kryeqyteti i Kosovës. Në periudhën dy vjeçare, nga MTPT-ja, në rajonin e Prishtinës janë investuar mbi 18.7 milion euro derisa në Skenderaj janë investuar hiç më pak se mbi 19 milion euro nga buxheti i shtetit. Ndërkaq, në qytezën e Drenasit, gjatë periudhës Janar 2008 – Dhjetor 2010 është investuar pothuajse shuma e njëjtë e parave sa në Prizren. Në qytete tjera të mëdha si Peja e Mitrovica është investuar disa herë më pak se sa në disa komuna dukshëm më të vogla të Kosovës.



Për sa i përket investimeve në rajone të ndryshme të vendit nga ana e MASHT-it, ka një shpërndarje më proporcionale të investimeve nëpër komunat e Kosovës. Megjithatë, komuna e Therandës, prej nga edhe vjen ish ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj, ka përfituar miliona euro më shumë se sa komunat më të mëdha si Peja, Mitrovica apo edhe Gjakova.



“Preportr” ka shikuar edhe shpërndarjen e përgjithshme të investimeve publike të bëra nga këto dy ministri në komunat e Kosovës. Nga totali i investimeve të bëra

nga MTPT-ja dhe MASHT-i, del se komunat që tradicionalisht kanë qenë bastione të PDK-së, por edhe në ato komuna ku interesi elektoral i PDK ka qenë i madh, kanë përfituar më shumë në krahasim me komunat tjera që për nga numri i banorëve janë shumë herë më të mëdha.

**Investimet në total nga MTPT-ja dhe MASHT-i nëpër Komuna të ndryshme të Kosovës:**

|                  | MTPT                | MASHT               |
|------------------|---------------------|---------------------|
| <b>Prishtinë</b> | <b>18,711,795 €</b> | <b>17,568,152 €</b> |
| <b>Total</b>     |                     | <b>36,279,947 €</b> |
| <b>Skënderaj</b> | <b>19,002,584 €</b> | <b>4,810,321 €</b>  |
| <b>Total</b>     |                     | <b>23,812,905 €</b> |
| <b>Prizren</b>   | <b>12,484,173 €</b> | <b>10,695,812 €</b> |
| <b>Total</b>     |                     | <b>23,179,985 €</b> |
| <b>Lipjan</b>    | <b>13,518,671 €</b> | <b>4,393,460 €</b>  |
| <b>Total</b>     |                     | <b>17,912,131 €</b> |
| <b>Drenas</b>    | <b>12,137,395 €</b> | <b>3,329,966 €</b>  |
| <b>Total</b>     |                     | <b>15,467,361 €</b> |
| <b>Mitrovica</b> | <b>8,061,438 €</b>  | <b>5,098,024 €</b>  |
| <b>Total</b>     |                     | <b>13,159,462 €</b> |
| <b>Peja</b>      | <b>5,614,044 €</b>  | <b>6,895,368 €</b>  |
| <b>Total</b>     |                     | <b>12,509,412 €</b> |
| <b>Therandë</b>  | <b>4,505,105 €</b>  | <b>7,635,384 €</b>  |
| <b>Total</b>     |                     | <b>12,140,489 €</b> |
| <b>Gjakova</b>   | <b>6,210,926 €</b>  | <b>5,827,188 €</b>  |
| <b>Total</b>     |                     | <b>12,038,114 €</b> |

Megjithëse Skënderaj për nga investimet del mbi vendbanime shumë herë më të mëdha si Prizreni, Mitrovica, Peja, Gjakova, prapë ky grafik duket normal kur merret parasysh se nuk ka ndonjë ndryshim të madh në investime në mes komunave të ndryshme. Mirëpo, nëse marrim parasysh se një pjesë e madhe e tenderëve u është dhënë kompanive të afërta me PDK-në, ose u është dhënë konsorciumeve që kanë brenda të paktën një kompani nga rajonet tradicionale të PDK-së, del se qartësisht ndarja e këtyre tenderëve është bërë në mënyrë politike. Prandaj, këto investime nuk kanë efektin e proklamuar për këto vendbanime duke qenë se kompanitë përfituese prapë janë ato të afërta me pushtetin duke bërë kështu që edhe paratë nga investimet në komunat, që nuk i takojnë tradicionalisht PDK-së, të kthehen në komunat që kanë votuar gjithmonë këtë parti. Grafikoni, poashtu tregon se komuna të vogla si Theranda, Skënderaj, apo Drenasi, ose barazohen ose i kalojnë komunat shumë më të mëdha si Mitrovica, Gjakova e Peja. Pra kemi të bëjmë me përfitime në projekte investuese, por edhe me përfitime të kompanive me

prejardhje të caktuar të këtyre projekteve në varësi nga interesi politik i partisë në pushtet.

### Ministritë nuk pranojnë që të takohen me “Preportr”

“Preportr” ka kërkuar nga ministria e Transportit dhe e Arsimit që të ketë qasje në dosjet e tenderëve, në mënyrë që të krijoj një pasqyrë më të plotë dhe më të qartë rreth procedurave të dhënies së tenderëve, që këto dy institucione publike i kanë kontraktuar gjatë viteve 2008-2010. Qëllimi ishte që të verifikohet se sa këta tenderë, janë dhënë në përputhje me kushtet e përcaktuara me Ligjin për prokurim publik. Po ashtu, qëllimi i “Preportr” ishte të shoh nëse këto dy ministri kanë pasur paraprakisht ndonjë plan të investimeve kapitale para se t’i marrin vendimet për të investuar në rajone të ndryshme të vendit. Përkundër kërkesës zyrtare për takim dhe pritjes për më shumë se tri javë për përgjigje nga ana e departamenteve të prokurimit brenda këtyre ministrive, “Preportr” nuk mori përgjigje.

### Fusha e prokurimit publik më e prekura nga korrupsioni

Sipas Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, fusha e prokurimit publik në Kosovë është më e prekura për sa i përket shpërdorimit të parasë publike nga zyrtarë qeveritarë. AKK-ja, në vazhdimësi në raportet e saja ka cekur se prokurimi publik në Kosovë në shumë raste bëhet duke e thyer ligjin më qëllim të përfitimeve të individëve apo kompanive të caktuara. “Veprimet apo mos veprimet e përmendura i referohen, në rastet më të shpeshta, shkeljes së procedurave të prokurimit ku në mënyrë të hapur dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik, janë dhënë kontrata publike operatorëve ekonomik duke favorizuar të njëjtit, ndërsa që janë eliminuar operatorët ekonomik të cilët i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara me dosjen e tenderit”, thuhet në Raportin e AKK-së për vitin 2010.

Zyrtari i lartë për hetim në AKK, Blerim Kelmendi, tregon për “Preportr” se format më të shprehura të akteve të korrupsionit, për sa i përket fushës së prokurimit publik kanë të bëjnë me aspektin e shpërdorimit të detyrës zyrtare, favorizim të kompanive të caktuara në dëm të të tjerave, falsifikim masiv të dokumenteve, shpërdorim të detyrës zyrtare nga komisionet e prokurimit, falsifikim i diplo-

mave të stafit teknik, falsifikim i autorizimit të përfaqësimit të ndërmarrjeve ndërkombëtare ose falsifikim i licencave të këtyre ndërmarrjeve si dhe marrje të ryshfetit.

Edhe raporti i AKK-së, për vitin 2010, e mbështet pohimin e këtij zyrtari. Raporti thotë që: “Gjatë hetimeve janë gjetur prova të cilat tregojnë për falsifikim masiv të dokumenteve zyrtare me qëllim të dhënies së kontratave publike operatorëve ekonomik përkatës, duke përdorur madje edhe emra fiktiv të personelit profesional si dhe duke falsifikuar kontrata të punës me individë të cilët nuk kanë qenë asnjëherë të punësuar në kuadër të operatorëve përkatës, falsifikimi i raporteve për kryerjen e punëve të cilat në fakt nuk janë kryer ndërsa që është bërë pagesa nga autoritetet kontraktuese. Po ashtu problematike paraqitet edhe çështja e vërtetimeve për kryerjen e obligimeve ndaj shtetit ku janë gjetur se dokumentet e tilla janë falsifikuar në mënyrë të vazhdueshme. Marrja e ryshfetit, kryesisht ndodhë në raste kur kërkohet ryshfet në këmbim të dhënies së ndonjë favorit apo përfitimi tjetër”.

Raportet e AKK-së, përgjatë gjithë kohës prej se është themeluar ky institucion për luftimin e korrupsionit, kanë vënë në pah se fusha e prokurimeve publike është më e prekura për sa i përket shpërdorimit të parasë publike. Raporti për vitin 2009 pak a shumë konstaton gjendje të njëjtë me atë të viti 2010. Aty thuhet që: “në rastet më të shpeshta, shkeljes së procedurave të prokurimit ku në mënyrë të hapur dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik, janë dhënë kontrata publike operatorëve ekonomik duke favorizuar të njëjtit, ndërsa që janë eliminuar operatorët ekonomik të cilët i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara me dosjen e tenderit”.

Po ashtu, raporti për vitin 2008 i AKK-së, vlerëson që gjendja në prokurim është majft e rëndë dhe kryesisht përcillet me shkelje të ligjit në fuqi. “Zhvillimi i procedurave të prokurimit, nga ana e departamenteve është në kundërshtim me ligjin për prokurim publik, shpesh herë nuk zbatohet fare ligji i prokurimit, falsifikimi i dokumentacioneve zyrtare (raporteve në lidhje me procedurat e prokurimit), pagesat e bëra pa përfunduar punimet ose akoma pa filluar po ashtu ajo që është me skandalozja ka të bëjë me miratimin e këtyre dokumenteve nga ana e menaxhereve të institucioneve” thuhet në raportin e AKK-së.

### Kontestohen rezultatet pozitive të investimeve

Njohës të zhvillimeve në vend, për sa i përket shpenzimeve qeveritare, shprehen se investimet kapitale të bëra nga këto dy ministri, faktikisht nuk kanë dhënë rezultatin e pritur. Ata shprehen skeptik me mënyrën se si janë bërë këto investime dhe ku janë investuar paratë. Për këta njohës të zhvillimeve në vend, qeveritë e deri tashme, e sidomos kjo e fundit, nuk kanë pasur ndonjë plan konkret të zhvillimit ekonomik si dhe plan studimi i cili u tregon se kur dhe pse duhet të investohet. Lumir Abdixhiku, drejtor i Institutit RIINVEST, kundërshton mënyrën se si janë shpenzuar miliona euro në investime kapitale.

“Zhvillimi ekonomik nuk ka nisë prej ndonjë strategjie me prioritete e që tani gradualisht kishte për t’u ndërtuar edhe buxheti, por buxheti është ndërtuar në bazë të votave, në bazë të shoqërisë ose dostnillakut me ministra, në bazë të komunave ku ata e kanë prejardhjen, dhe në bazë të kësaj është bërë shpërndarja e buxhetit dhe gradualisht janë ndërtuar prioritetet ekonomike”.

*Lumir Abdixhiku*

Abdixhiku konsideron që arsyetimet e qeveritarëve se paraja publike ka shkuar aty ku nuk ka pasur investime me vite, janë justifikime të paarsyeshme pasi që paraja e shtetit duhet të investohet aty ku edhe mund të rigjenerohet. “Argumenti i qeverisë thotë që vendet ku është investuar, vatrat prej të cilave kanë ardhur, kanë qenë vendet më të pazhvilluara historikisht. Mirëpo, investimi kapital bëhet aty ku ka aftësi për t’i rigjeneruar ato pare”, thotë Abdixhiku.

Edhe për kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, investimet publike janë bërë pa ndonjë plan konkret dhe si të tilla kanë shkuar në xhepa dhe në rajone të afërta me politikën. “Kosovës i mungon një plan zhvillimor, dhe po të kishim një plan zhvillimor investimet kishin me gjenrëruar zhvillim ekonomik, kishin me e ulë papunsisë”, thotë Gërxhaliu. ■



Foto: Lorik Bajrami



Kompanitë me licenca të pezulluara marrin tenderë nga MASHT dhe MTPT

# Tenderët kundërligjorë

VIJON NGA FAQJA E PARË

ARTON DEMHASAJ

Hulumtimi i “Preportr”, tregon se në shtatë tenderë të marrë në shikim, janë dhënë mbi dy milionë euro për katër kompani private ndërtimore nga institucionet e Kosovës edhe pse në atë kohë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë u është marrë licenca për operim për shkak të mosplotësismit të kushteve.

|                                                                                                             |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1. NNT “Mirusha Transport”</b> nga Klina, ka marrë tender nga MTPT-ja më 24.10.2008, në vlerë 114,719 €. |
| <b>2. NNP “Tosi”</b> nga Peja, ka fituar tre tenderë nga MASHT-i.                                           |
| a) Më 06.10.2008, ka fituar tender në vlerë 815,840 €.                                                      |
| b) Më 03.11.2008 ka fituar tender në vlerë prej 427,842 €.                                                  |
| c) Më 17.10.2008 ka fituar tender në vlerë prej 81,878 €.                                                   |
| <b>3. NNTSH “Sallahu”</b> nga Kaçaniku, ka fituar tender nga MTPT-ja, në vlerë prej 326,400 €.              |
| <b>4. NPN “Bajramaj”</b> nga Theranda, ka marrë dy tenderë nga MASHT-i.                                     |
| a) Më 07.11.2008, ka fituar tender në vlerë 126,602 €.                                                      |
| b) Më 02.10.2008 ka fituar tender në vlerë 252.924 €.                                                       |

Totali i shumës së dhënë katër kompanive me licenca të pezulluara është:

## 2.146.205 €

Komisioni për Ndërtim dhe Licenca i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në bazë të Ligjit për Ndërtim, ka për autorizim që në rast se një kompani nuk ka plotësuar kushtet teknike t’i marrë licencën një subjekti ekonomik. Sipas ligjit në fuqi, një kompani që i është pezulluar licenca nuk mund të shpërblehet me tenderë publik. Përkundër kësaj, kompanitë me licenca të pezulluara kanë marrë tenderë nga ana e Ministrisë së Transportit Postës dhe Telekomunikacionit (MTPT) dhe Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Kohëzgjatja e pezullimit të licensave:

|                                                                                            |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1. NNT “Mirusha Transport”</b> - Klinë 926-70457391 <b>6 muaj</b> 17.09.2008-17.03.2009 |
| <b>2. NNP “Tosi”</b> - Pejë-383 80461275 <b>6 muaj</b> 17.09.2008-17.03.2009               |
| <b>3. NNTSH “Sallahu”</b> - Kaçanik 541-80021194 <b>6 muaj</b> 17.09.2008-17.03.2009       |
| <b>4. NPN “Bajramaj”</b> - Therandë 448-70251052 <b>6 muaj</b> 17.09.2008 -17.03.2009.     |

Përkundër ndalimit të qartë, këto kompani kanë marrë tenderë për ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve dhe shkollave. Duke qenë se këto kompani nuk kanë pasur të drejtë të ushtrimit të veprimtarisë në

ndërtimtari, deri sa ka qenë në fuqi vendimi i Komisionit të Licencave, dhënja e tenderëve për këto kompani përbën disa vepra të dënueshme me ligj duke filluar nga shkelja e detyrës zyrtare, cenimin e konkurrencës së lirë e deri te mundësia e veprës së korrupsionit. Madje sipas legjislacionit në fuqi, edhe pas kalimit të afatit të pezullimit të licencave, kompanitë në fjalë është dashur të aplikojnë sërish për licenca.

Nga kontaktimi i “Preportr” me përfaqësues të kompanisë “Bajramaj” nga Theranda, komunikohet se asnjëherë nuk kanë marrë vendim nga MTI-ja për pezullim licence, edhe pse vendimi për pezullim të licencave të kompanive është i publikuar në web faqe të MTI-së.

Përfaqësuesi i kompanisë “Mirusha Transport” nga Klina, pranon se i është pezulluar licenca nga MTI-ja, por thotë se kanë bërë ankesë dhe se nuk ka njohuri se çka ka ndodhur më tutje, pra nëse është shfuqizuar ose jo vendimi. Ai pranon marrjen e tenderit nga MTPT-ja. Megjithatë, ankesa e bërë nga “Mirusha Transport” juridikisht nuk e shfuqizon vendimin deri në marrjen e një vendimi të ri. Kurse, në web faqen e MTI-së, nuk gjendet një vendim i ri karshi vendimit për pezullim të licences për këtë kompani.

“Preportr” ka tentuar që të marrë përgjigje edhe nga përfaqësuesit e dy kompanive tjera, “Sallahu” dhe “Tosi”, përmes numrave të tyre zyrtar, por komunikimi me ta ka qenë i pamundur.

“Preportr” ka kontaktuar disa herë edhe me përfaqësuesit e MTPT-së dhe të MASHT-it, por këto dy institucione nuk kanë pranuar që të takohen.

Ilir Kryeziu, Drejtor i Departamentit për Ndërtim në MTI, pohon për “Preportr”, se çdo subjekt ndërtimor, në bazë të Ligjit për Ndërtim, është i obliguar që të licencohet në MTI. “Kompanitë nuk mund ta ushetrojnë veprimtarinë pa licencë. Mbikëqyrjen e licencës e bën Inspektorati i Tregut”, thotë Kryeziu. Sipas tij, vendimet për pezullim të licencës merren nga Komisioni për Licencimin e Subjekteve Ndërtimore dhe lista e subjekteve të pezulluara, përkatësisht të anuluar, publikohet në web faqen e MTI-së, si dhe dërgohet në organet kompetente si KRPP-ja, OSHP-ja si dhe, APP-ja.

Kryeziu, sqaron se Komisioni për Licencimin e Subjekteve Ndërtimore nuk merr masa ndëshkimore ndaj kompanive që kanë shkelur vendimin për pezullim. Pra, sipas Kryeziut, masa ndëshkimore e vetme që merret nga Komisioni për Licencimin e Subjekteve Ndërtimore është vendimi për pezullim, përkatësisht vendimi për anulim të licencës.

Në anën tjetër, Ilaz Duli, anëtar i bordit të KRPP-së, thotë se në bazë të legjislacionit në fuqi, operatori ekonomik nuk mund të marrë punë në kohën sa e ka licencën të pezulluar, dhe se ministritë e caktuara, dhënëse të tenderit, janë shkelëse të ligjit. Ndalimi i marrjes së tenderëve nga kompani me licenca të pezulluara sanksiono-

het edhe në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik me Nenin 65, paragrafi 4, paragrafi 4.5, dhe paragrafi 4.11, si dhe me nenin 69. Po ashtu, edhe Udhëzimi Administrativ nr 10/2010, “Për licencimin e subjekteve ndërtimore”, përmes nenit 35 paragrafi 4, si dhe nenit 40 paragrafi 1 dhe 3, ndalon dhënien e tenderëve kompanive me licenca të pezulluara.

Sipas Blerim Kelmendit, zyrtar i lartë për hetime në Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit, dhënia e tenderëve nga Departamentet e Prokurimit të ministrive përkatëse, kompanive me licenca të pezulluara, mund të merret si shpërdorim i detyrës zyrtare nga përfaqësuesit të komisioneve të prokurimit.


Shpërdorimi i detyrës zyrtare sipas Kodit Penal të Kosovës paraqet vepër penale kundër detyrës zyrtare dhe si e tillë është penalisht e dënueshme. Edhe pse shumica e rasteve që AKK-ja i procedon, janë në fushën e prokurimit publik, ata thonë se nuk kanë pasur informacion se tenderët u janë dhënë kompanive me licenca të pezulluara.

Në të dy raportet e AKK-së, për vitet 2009 dhe 2010, janë gjetur prova të cilat tregojnë për falsifikim masiv të dokumenteve zyrtare me qëllim të dhënies së kontratave publike operatorëve ekonomik përkatës, duke përdorur madje edhe emra fiktiv të personelit profesional si dhe duke falsifikuar kontrata të punës me individ të cilët nuk kanë qenë asnjëherë të punësuar në kuadër të operatorëve përkatës. ■



Foto: Lorik Bajrami





Financuesit e PDK-së marrin tenderë milionësh

## Magjia e 500 eurove në politikë

VIJON NGA FAQJA E PARË

FLORIE XHEMAJLI  
QËNDRIM BUNJAKU

**PRISHTINË, MAJ** – Miliona euro, para të buxhetit të vendit, iu janë dhënë ndër-marrjeve të ndryshme private, pronarët e të cilave kanë qenë financuesit e fushatës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009. Një shumë afër 40 milion euro i'u është dhënë 8 kompanive të ndryshme përmes 24 tenderëve publik nga Ministria e Transportit dhe ajo e Arsimit. Pronarët e këtyre kompanive, sipas raportit zyrtar të auditimit të KQZ-së, kanë dhënë para për financimin e fushatës elektorale të PDK-së gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009.

**Shuma e parave që kanë marrë kompanitë që kanë financuar fushatën e PDK-së të vitit 2009**

**Total 39,818,600 €**

8 kompani  
përfutuese  
24 tenderë

Një krahasim i kompanive që kanë fituar tenderë publik nga këto dy ministri, me të dhënat e marra nga Agjencioni i Regjistrimit të Bisneseve (ARBK), si dhe të dhënat nga raporti zyrtar i auditimit të KQZ-së, tregojnë se miliona euro, fonde publike, u janë dhënë kompanive të cilat direkt kanë financuar fushatën e PDK-së gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009.

Këta tenderë u janë dhënë këtyre kompanive përgjatë viteve 2008-2010, kohë kjo kur PDK-ja kishte marrë pushtetin në Kosovë në fund të 2007.

Në kontaktet që "Preportr" ka arritur t'i ketë me disa prej drejtuesve të këtyre kompanive, një pjesë e tyre kanë pranuar se kanë dhënë para për fushatën e PDK-së për zgjedhjet lokale të vitit 2009. Ndërsa, disa prej tyre nuk kanë pranuar që kanë financuar PDK-në, edhe pse të dhënat në raportin e KQZ-së përputhen plotësisht me ato të kontratave që Ministria e Transportit dhe ajo e Arsimit kanë nënshkruar me kompanitë e të përmendurve si dhe me të dhënat e marra nga ARBK-ja. Njëri prej drejtuesve të kompanive ka refuzuar kategorikisht që të përgjigjet në pyetjen e "Preportr", rreth financimit të fushatës së PDK-së, duke pohuar që kjo është çështje personale e tij.

Përveç të dhënave të auditorit dhe të ARBK-së, "Preportr" ka gjetur që në dy raste është thyer Ligji për Financimin e Partive Politike pasi që, dy prej drejtuesve të kompanive, fituese të tenderëve, kanë tejkaluar limitet e përcaktuara me ligj për sa i përket shumës së parave që subjektet fizike mund t'u dhurojnë partive politike.

### Konfirmimi i dhënies së parave

Nga kontaktimi i disa financuesve të partisë në pushtet, del se fitues të tenderëve publik kanë dhënë donacione për PDK-në. Megjithatë ata flasin për shuma shumë më të ulëta, nga raportet e auditorit del se jo rrallë, shumat e raportuara nga partitë politike janë në shpërputhje me shumat që janë dhënë në të vërtetë nga një person fizik ose juridik. Kështu, kompania "Magjistrallja" ka financuar Degën e PDK-së në Gjilan me 2,500 euro, të deklaruar, ndërsa sipas auditorit, të gjetura janë 31,500 euro, si para që realisht janë dhënë për të financuar fushatën e PDK-së.

Kompania "Magjistrallja", ka financuar Degën e PDK-së në Gjilan me

**2,500 €**

(të deklaruar) ndërsa, sipas auditorit, të gjetura janë

**31,500 €**

si para që realisht janë dhënë për të financuar fushatën e PDK-së

"Preportr" ka gjetur se Naim Besimi, pronar i kompanisë "Getoari" nga Prizreni, ka financuar degën e PDK-së në Shtime me 500 euro gjatë fushatës elektorale të vitit 2009. Kompania e tij, ka përfutur 3,469,557 euro nga 3 tenderë nga Ministria e Transportit si dhe 689,626 euro nga 1 tender tjetër nga Ministria e Arsimit. Naim Besimi ka konfirmuar për "Preportr" që ka dhënë para për fushatën e PDK-së në zgjedhjet lokale të vitit 2009. Ai madje pyet se sa është vlera që KQZ-ja ka paraqitur në raportin e saj, duke lënë të kuptohet që shuma e dhënë nga Besimi edhe mund të jetë më e madhe se sa ajo e raportuar. "Sa është shuma e cekur aty, po po unë i kanë dhënë ato para" shton Besimi, kur pyetet nga gazetarët e "Preportr" se a ka financuar ai fushatën e PDK-së të zgjedhjeve lokale të vitit 2009.

Reshat Kamberi, pronar i kompanisë "Engineering" nga Viti, po ashtu ka dhënë donacion në vlerë prej 1000 euro për degën e PDK-së në Viti. Kompani "Engineering", ka përfutur 1,735,631 euro nga 3 tenderë publik që janë dhënë nga MASHT-i. Kamberi, po ashtu ka pranuar për "Preportr", që ai ka dhënë para për fushatën e PDK-së për vitin 2009. "Po është e vërtetë që unë kam dhënë para për

fushatën e PDK-së, për degën në Viti", ka pranuar Kamberi.

Viktor Delia, pronar i kompanisë "Delia Group" nga Tirana, ka financuar PDK-në, dega e Shtimës me 500 euro. "Delia Group" ka fituar 1 tenderë në vlerë 11,760,439 euro nga MTPT-ja.

Viktor Delia ka pranuar për "Preportr", që ai ka dhënë mjete financiare për PDK-në në vitin 2009. "Po kam dhënë para për PDK-në gjatë fushatës elektorale, dega në Shtime në vitin 2009", është shprehur Delia.

**Jep 500 €, merr 11 milionë €:**

Viktor Delia, pronar i kompanisë "Delia Group" nga Tirana, ka financuar PDK-në, dega e Shtimës me 500 €. "Delia Group" ka fituar 1 tenderë nga MTPT-ja në vlerë:

**11,760,439 €**

### Nuk konfirmojnë, por të dhënat përputhen

Bujar Shabani, pronar i kompanisë "Bageri" nga Ferizaj, ka financuar degën e PDK-së në Shtime me 1000 euro. Kompania "Bageri" ka fituar 1 tender nga MTPT-ja në vlerë prej 829,569 euro. Shabani, i kontaktuar nga "Preportr", nuk ka pranuar që të deklarohet nëse ai ka dhënë mjete financiare për fushatën e PDK-së të vitit 2009. Ai madje thotë që "të dhënat rreth financimit të PDK-së janë sekrete personale". Megjithatë, sipas të dhënave zyrtare, del që Bujar Shabani, pronar i kompanisë

“Bageri”, në fakt është personi i cili ka dhënë para për PDK-në. Në të dhënat e ARBK-së, figuron emri i Bujar Shabanit si pronar i kompanisë, përderisa në raportin zyrtar të auditimit të KQZ-së, rreth fushatës zgjedhore të PDK-së, emri i Bujar Shabanit figuron si njëri nga financuesit e fushatës së PDK-së në vitin 2009. Mustafë Bajraktari, pronar i kompanisë “Bajraktari”, ka dhënë donacion për degën e PDK-së në Vushtrri, në vlerë prej 500 euro. Kompania që udhëheqë ai ka fituar tender nga MTPT-ja, në vlerë 123,287 euro, për punën “Punimi i trotuarit Runik”. “Preportr”, ka provuar që të kontaktoj me Mustafë Bajraktarin, por ka qenë e pamundur. Sidoqoftë, “Preportr” ka gjetur që Mustafë Bajraktari, është nga fshati Magjunaj, komuna e Vushtrrisë, si dhe sipas kontratës, operatori ekonomik fitues i tenderit në MTPT-në, “Bajraktari”, është po ashtu nga Magjunaj.

## Të gjithë nga 500 €

Është interesante që edhe pse të dhënat e auditorit kanë konfirmuar se ekziston shpërputhje mes shumave të deklaruara dhe atyre të dhëna, në të vërtetë shumica e donatorëve që kanë fituar tenderë publik deklarojnë se kanë dhënë donacion prej vetëm 500 eurosh për PDK-në.

Ismet Konushevc, pronar i kompanisë “Beni Com” nga Prishtina, ka financuar degën e PDK-së në Podujevë me 1900 euro. Kompania “Beni Com” ka përfituar 9,157,830 euro përmes 5 tenderëve publik nga MTPT-ja. Konushevc i kontaktuar nga “Preportr”, nuk ka pranuar që ka dhënë donacion për fushatën e PDK-së.

### Thyerja e Ligjit për Financimin e Partive Politike

“Preportr”, gjatë këtij hulumtimi, ka gjetur që dy prej drejtuesve të kompanive, të cilët po ashtu kanë dhënë para për fushatën e PDK-së, kanë thyer Ligjin për Financimin e Partive Politike. Për më tepër, “Preportr” po ashtu ka gjetur që në një rast, një kompani e cila ka qenë përfrituese direkte e tenderëve publik si dhe njëra nga financuesit e fushatës së PDK-së, sipas raportit zyrtar të auditimit të KQZ-së, ka deklaruar shuma më të vogla të financimit të fushatës së PDK-së, se sa që realisht ka dhënë. Florim Zuka, pronar i kompanisë “Tali” nga Gjilani, ka dhënë donacion për PDK-në, dega në Gjilan, në vlerë prej 8000 euro. Ndërsa, kompania e tij “Tali”, ka përfituar gjatë 3 viteve të fundit, 5,475,108 euro nga 6 tenderë prej MTPT-së. Basri Kçiku, pronar i kompanisë “Bejta Commerce”, po ashtu nga Gjilani, ka dhënë donacion në vlerë prej 10,000 eurosh për degën e PDK-së në Gjilan, përderisa kompania e tij ka përfituar 7,545,543 euro nga 3 tenderë në MTPT. Sipas raportit zyrtar të auditimit të KQZ-së, për zgjedhjet lokale të vitit 2009, këta dy persona, si subjekte fizike, kanë dhënë shuma parash që janë në kundërshtim me Ligjin për Financimin e Partive Politike. Në Raport thuhet që, Florim Zuka ka

dhënë 8,000 euro për fushatën e PDK-së, përderisa, Basri Kçiku ka dhënë 10,000 euro. Ky veprim i këtyre dy personave, paraqet thyerje të Ligjit për Financimin e Partive Politike në Kosovë pasi që, ligji parasheh që personat fizik lejohen të japin jo më shumë se 2,000 euro brenda një viti kalendarik. “Subjektet Politike lejohen të marrin kontribute nga: personat fizik, në vlerë prej, jo më shumë se dy mijë (2,000) Euro për një (1) vit kalendarik” shkruan neni 1 dhe 1.1 i Ligjit.

Ligji për Financimin e Partive Politike, parasheh që shuma të tilla parash mund të jepen vetëm nga “persona juridik” po jo edhe nga personat fizik. Neni 1 dhe 1.2. i Ligjit thotë: “Subjektet Politike lejohen të marrin kontribute nga: personat juridik në vlerë prej - jo më shumë se dhjetëmijë (10.000) Euro për një (1) vit kalendarik”.

Në anën tjetër, hulumtimi i “Preportr”, ka gjetur se kompania “Magjistrallja”, ka financuar Degën e PDK-së në Gjilan me 2,500 euro (të deklaruara) ndërsa, sipas auditorit, të gjetura janë 31,500 euro si para që realisht janë dhënë për të financuar fushatën e PDK-së. Kompania “Magjistrallja”, në vitin 2008 ka fituar një pjesë të tenderit për “Mirëmbajtjen dimërore të rrugëve magjistrale-regjionale të Kosovës” në regjionin e Gjilanit në vlerë prej 291,251 euro nga MTPT-ja.

### Mangësitë e Ligjit për Financimin e Partive Politike

Ligji për Financimin e Partive Politike, në asnjë prej neneve të tij, nuk e ndalon që ndërmarrjet private, të cilat kanë fituar kontrata me institucionet publike të japin para për financimin e partive politike. Po ashtu, ligji nuk e ndalon që ato ndërmarrje private, të cilat financojnë Partitë Politike, të fitojnë tenderë nga institucionet publike. Përkundrazi, Ligji për Financimin e Partive Politike, në mënyrë indirekte lejon që ndërmarrjet private, të cilat kryejnë punë/shërbime për institucionet e shtetit të financojnë partitë politike. Neni 3.5 i ligjit thotë që: “subjektet politike që pranojnë kontribute nga Ndërmarrjet Private, të cilat, përmes kontratave me Institucionet e shtetit, kryejnë shërbime, duhet të përgatisin një listë të veçantë të kontributeve të pranuar”. Po ashtu, e metë tjetër e ligjit është edhe pjesa e ndëshkimeve që parashihi në rast të shkeljeve të dispozitave të tij. Ligji, realisht parasheh vetëm sanksione përmes gjobave kur thyhen dispozitat e tij, por jo edhe ndonjë sanksion penal. Si i tillë, ligji konsiderohet si shumë i mangët që të parandaloj apo luftoj veprime të cilat edhe mund të kenë karakter korruptiv. “Preportr” ka bërë përpjekje për të kontaktuar me zyrtarë të Ministrisë së Transportit dhe të Arsimit, por asnjëra nga këto dy ministri nuk iu është përgjigjur kërkesës së gazetës për takim. Madje, “Preportr” ka dërguar edhe kërkesë zyrtare për takim, por prapë, edhe pse kemi pritur për më shumë se tri javë, dy ministrinë nuk kanë kthyer përgjigje pozitive për takim. ■

| Dispozitat ndëshkimore të Ligjit për Financimin e Partive Politike                                                                                                                                                                                                                    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Subjekti politik do të gjobitet prej tremijë (3.000) deri në dhjetëmijë (10.000) €, ndërsa, Kandidatët për deputet dhe këshilltarë si dhe kandidatët e pavarur do të gjobitet prej pesëqind (500) deri në tremijë (3.000) €, për cenim të dispozitave të këtij ligji, në qoftë se: |
| 1.1. pranon mjete financiare në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;                                                                                                                                                                            |
| 1.2. mban shënimet në regjistrat e veta në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;                                                                                                                                                                 |
| 1.3. nuk i përmbahen dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave tjera të ligjeve tjera në fuqi, për zgjedhjet e përgjithshme dhe zgjedhjet lokale.                                                                                                                                    |
| 2. Një subjekt politik, i cili nuk e paraqet raportin vjetor financiar KQZ - së brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, humb të drejtën për të përfituar nga fondi në vitin e ardhshëm.                                                                                             |
| 3. Personi përgjegjës brenda subjektit politik, dënohet në shumë prej treqind (300) deri në njëmijë (1.000) € për cenim e dispozitave të këtij ligj.                                                                                                                                  |

| GRAFIKONI me detaje për secilën kompani dhe tender të fituar                                                                                                                                                                           |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. “Getoari”                                                                                                                                                                                                                           |
| Në vitin 2008 kompania “Getoari” ka fituar tender nga MTPT-ja për “Ndërtimim dhe Asfaltimin e Rrugës Dragobillë-Shkozë” në vlerë 365,865 €.                                                                                            |
| Kompania e njëjtë në vitin 2009 ka fituar tender nga MTPT-ja për “Ndërtimin e rrugës Reqan-Llukvicë-Struzhë” në vlerë 2,416,111 €.                                                                                                     |
| Në vitin 2009, kompania “Getoari” ka fituar një pjesë të tenderit përkatësisht LOT 6 për “Ndërtimin e urave në zgjerimin e rrugës nacionale M9, segmenti Sllatinë-Gjurgjicë” në vlerë 687,581 €.                                       |
| “Getoari” ka marrë punë edhe nga MASHT-i, ku në vitin 2008 ka fituar tenderin për “Ndërtimin e shkollës fillore në Prizren faza e II-të”. Kontrata për këtë punë kapë vlerën prej 689,626 €.                                           |
| 2. “Engineering”                                                                                                                                                                                                                       |
| Kompania “Engineering” në vitin 2008 ka fituar tenderin nga MASHT-i për “Ndërtimin e shkollës fillore” Letanc Podujevë në vlerë 491,648 €.                                                                                             |
| Në vitin 2009, “Engineering” ka fituar një tender tjetër nga MASHT-i për “Ndërtimin e murit mbrojtës në shkollën fillore Nebregoshte-Prizren” në vlerë 23,439 €.                                                                       |
| Në vitin 2008, kompania “Engineering” ka fituar tenderin për “Ndërtimin e objektit të shkollës fillore në Kamenicë, faza e I-rë” në vlerë 1,220,554 €.                                                                                 |
| 3. “Delia Group”                                                                                                                                                                                                                       |
| Kompania “Delia Group”, në vitin 2009 ka fituar LOT-in 2C në tenderin nga MTPT-ja, “Zgjerimi i rrugës nacionale M9, segmenti Sllatinë-Gjurgjicë i ndarë në 5 LOT-e”. Vlera e kontratës që “Delia Group” ka fituar është 11,760,439 €.  |
| 4. “Bajraktari”                                                                                                                                                                                                                        |
| Kompania “Bajraktari” ka fituar tender në vitin 2009 për “Punimin e trotuarit Runik” në vlerë prej 123,287 €.                                                                                                                          |
| 5. “Bageri”                                                                                                                                                                                                                            |
| Kompania “Bageri” ka fituar tenderin për “Rehabilitimin e rrugës M25.2 Prishtinë-Gjilan, pjesa Hajvali-Mramuer”, në vlerë prej 829,569 €, nga MTPT-ja.                                                                                 |
| 6. “Beni Com”                                                                                                                                                                                                                          |
| Në vitin 2008, Kompania “Beni Com”, ka fituar tenderin për “Ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës për Jezerc L=7.270m” në vlerë 950,023 €, nga MTPT-ja.                                                                                    |
| Në vitin 2008, “Beni Com”, bashkë me një kompani tjetër ka marr tender për “Mirëmbajtjen dimërore të rrugëve magjistrale regjionale të Kosovës” regjioni Prishtina A në vlerë prej 618,987 €, nga MTPT-ja.                             |
| “Beni Com” ka fituar tenderin për “Ndërtimin e rreth rrotullimit-Obiliq (rrugë-kryqi Shkabaj)”, në vlerë 2,745,984 €, nga MTPT-ja.                                                                                                     |
| Në vitin 2008, “Beni Com”, ka fituar tenderin për “Zgjerimin e rrugës M2 (Prishtinë-Mitrovicë) segmenti Prishtinë Shkabaj, LOT II” në vlerë 4,266,234 €, nga MTPT-ja.                                                                  |
| Në vitin 2010, “Beni Com” ka fituar tender për: “NDËRTIMI I RRUGËS STROFC-BEQUK-MIHALIQ (K.K VUSHTERRI)”, në vlerë prej 616,602 €, nga MTPT-ja.                                                                                        |
| 7. “Tali”                                                                                                                                                                                                                              |
| Në vitin 2008, kompania “Tali” ka fituar nga MTPT-ja tenderin “Hartimi i projektit për zgjerimin e rrugës magjistrale M9 Prishtinë-Pejë, segmenti rrugor Udhëkryqi F.Kosovë-Udhëkryqi Arllat L=25 km” në vlerë 576,345 €.              |
| Në vitin 2009, ka fituar tenderin “Rikonstruimi i rrugës Hogosht-Kopernicë” në vlerë prej 410,152 €.                                                                                                                                   |
| Në vitin 2008 kompani “Tali”, së bashku me 2 kompani tjera, ka fituar tenderin për “Zgjerimin e rrugës M2, Pjesa Çagllavicë-M2/M25(QMI)km 1+600 deri km 5+200 faza e dytë, LOT1” në vlerë 2,799,411 €.                                 |
| Në vitin 2008 ka fituar tenderin për “Asfaltimin e rrugës lokale Muqivërc-Dajkoc-Qarakoc-Kolloleq” në vlerë 410,131 €.                                                                                                                 |
| Në vitin 2008 ka fituar tenderin për “Asfaltimin e rrugës Karaqevë e Poshtme-Muhovc” në vlerë 149,635 €.                                                                                                                               |
| Kompania “Tali” ka fituar edhe një tender tjetër nga MTPT-ja, për “Asfaltimin e rrugës Pogradjë-Dobrosin” në vlerë 1,121,434 €.                                                                                                        |
| 8. “Bejta Commerce”                                                                                                                                                                                                                    |
| Në vitin 2008, kompania “Bejta Commerce” ka fituar tenderin për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës Zajqec-Tuxhec, L=6,547,71 km ne vlerë 1,043,543 €.                                                                                   |
| “Bejta Commerce” ka fituar një pjesë të tenderit për “Ndërtimin e rrugës regjionale R(105) Palca – Vushtri, pjesa e I-rë prej km 0+000 deri 8+583,06 dhe pjesa e dytë prej 8+583,06 (e ndarë në dy pjesë/ LOT-e) në vlerë 1,677,786 €. |
| Në vitin 2009, “Bejta Commerce”, ka fitur edhe një tender tjetër nga MTPT-ja për “Ndërtimin e rrugës regjionale R209 Bresalc-Kishnapole-Gadime-Vrellë-17.17km” në vlerë 4,824,214 €.                                                   |